



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1655 Prot.

Tiranë, më datë 02.12.2021

VENDIM
Nr. 660, datë 02.12.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 02.12.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e Raportit të Vlerësimit të Potencialit Arkeologjik i realizuar nga individ i licencuar në arkeologji z. Lorenc Bejko në kuadër të projektit “Godinë me funksion banim + shërbime 9 kat me 1 kat nëntokë, Rr. “Lura””, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “B” të qytetit të Durrësit, me aplikues z. Kleant Bibolli, zhvillues Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Gjatë punimeve të gërmimit për projektin zhvillimor me objekt “Godinë me funksion banim + shërbime 9 kat me 1 kat nëntokë, Rr. “Lura””, brenda kufirit të Zonës Arkeologjike “B” të qytetit të Durrësit, të kryhet ndjekja në mënyrë periodike e punimeve nga DRTK Tiranë, të cilët duhet të raportojnë pranë IKTK-së;
4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

